Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa vlerë do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Oferta ekonomike e detajuar**

<b>Nr</b>	<b>Nr. Analizë</b>	<b>Përshkrimi i Punëve</b>	<b>Njësi</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi/ Njësi</b>	<b>Cmimi total</b>
1.						
2.						
3.						
<b>Shuma</b>						
<b>Fondi Rezervë</b>						
<b>Shuma</b>						
<b>TVSH</b>						
<b>SHUMA TOTAL</b>						

---

**Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_**

**Vula**

**Shënim:Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ ( e kërkuar në dokumentat e tenderit )**

**Shtojca 3.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

*[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]*

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

\* \* \*

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 4.**

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkëlqje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit****Nënshkrimi****Vula**

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/ Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE


**Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet** të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

#### 1. Llampadaret Plastik per makinat dhe kembesoret.

Llampadaret duhet te jene LED, te pajisur me certificate CE sipas EN 12368:2006


Te jene te diametrave 200mm dhe 300 mm me material polikarbonat I stabilizuar per rrezet UV, me ngjyre te zeze, jeshile dhe ngjyra sipas kerkeses. Duhet te jene te pajisur me kapele hijezimi per cdo llampadar. Duhet te jene te pajisur me aksesoret e kapjes ne shtylle metalike. Intesiteti I drites sipas EN12368:2015 duhet te jete me shume se 400 cd per ngjyren e kuqe dhe te gjelber me fluks te larte. Konsumi I energjise duhet te jete 7W ose me pak per cdo drite led te llampadarit ne tension 230VAC nen frekuence 50 HZ +-20%, me nje jetegjatesi mesatarisht 10 vjet. Llampadaret duhet te kene rezistence ndaj goditjes sipas EN60598-1, klasi IR3 sipas EN12368:2006. Nivel IP55 sipas EN60529 klasi 4 sipas EN12368:2006 per llampadarin dhe IP65 sipas EN60529 per moduln e dritave LED. Klasi I izolimit duhet te jete klas 2. Llampadaret duhet te jene funksional ne temperature -40 grade C - +60 grade C sipas EN60068-2-1-14 dhe klasi A,B,C sipas EN12368:2006. Te jene rezistent ndaj vibrimit sipas EN60068-2-64. Llampadaret duhet te jene te pajisur me maska treguese drejtimi/kembesoresh sipas klasit S1 dhe klasit C1,C2,C3,C4. Kolorimetria e ngjyrave e kuqe, portokalli dhe jeshile duhet te jene sipas EN12368:2006.

Dimensionet e llampadareve te jene si me posht:



Diametri	Numri l dritave LED	w	w2	h	h2	h3	h4	d	d2	d3	d4	d5	d6
200mm	1	265	/	246	405	262	70	110	196	386	/	/	/
	2				655	560							
	3				905	750							
300mm	1	363	/	346	503	365	70	152	273	505	/	/	/
	2				855	715							
	3				1205	1065							
300mm 200mm 200mm	3	363	265	346	1005	865	70	152	273	505	110	196	386

## 2. Modulet e llampave LED per llampadaret.



### 3. Modulet e llampave LED per llampadaret e kembesoreve (Jeshile dinamike).

Jetgatesia e muduleve, minimum 50,000 ore pune, te kene certificate CE, te jene conform EN 12368 per vibracionin dhe IR3 sipas EN60598-1 per rezistencen ndaj goditjes. Moduli te jete IP65 sipas EN60529. Te funksionojne ne temperature -40 deri ne +60 grade C.



Ngjyra	Sasia e LED	Intesiteti i drites	Gjatesia e vales	Kendi i shikimit		Fuqia	Voltazhi	Materiali
				M/D	L/P			
E Kuqe	66 cop	$\geq 20000\text{cd/m}^2$	$625 \pm 5\text{nm}$	30°	30°	$\leq 7\text{W}$	12/24VDC 85V-265VAC 50/60HZ	Polikarbonat UV rezistent
Jeshile	96 cop	$\geq 50000\text{cd/m}^2$	$505 \pm 5\text{nm}$	30°	30°	$\leq 9\text{W}$		

#### 4. Numurator per makina dhe kembesore D200 dhe D300

Moduli numërues (countdown) për semaforë rrugorë është një pajisje elektronike me teknologji LED, e projektuar për t'u integruar në sistemet ekzistuese të sinjalistikës rrugore dhe për të informuar përdoruesit e rrugës mbi kohën e mbetur të fazave të semaforit. Pajisja duhet të jetë e aftë të shfaqë në mënyrë të qartë dhe të lexueshme kohën e mbetur të fazës së gjelbër, të verdhë dhe të kuqe, duke kontribuar në rritjen e sigurisë rrugore dhe reduktimin e reagimeve të papritura nga drejtuesit e mjeteve dhe këmbësorët.

Pajisja duhet të funksionojë në mënyrë autonome nëpërmjet një sistemi të integruar vetë-mësimi, i cili regjistron ciklin e funksionimit të semaforit dhe fillon shfaqjen e kohës nga cikli i dytë. Ajo duhet të mundësojë gjithashtu komunikim të drejtpërdrejtë me kontrollorin e semaforit përmes një porte seriale, duke garantuar fleksibilitet në integrim dhe përdorim në konfigurime të ndryshme trafiku. Lidhja elektrike duhet të realizohet në paralel me sinjalet ekzistuese të semaforit pa kërkuar ndërhyrje në logjikën e kontrollorit.

Moduli duhet të jetë i ndërtuar mbi një sistem optik LED me intensitet të lartë (High Flux), i aftë të sigurojë dukshmëri të mirë në kushte të ndryshme ndriçimi, duke përfshirë rrezatim të drejtpërdrejtë diellor. Sistemi duhet të jetë i pajisur me sensor të brendshëm për rregullimin automatik të ndriçimit në varësi të kushteve ambientale. Segmentet e shfaqjes duhet të jenë të ndërtuara me konfigurim redundance, ku secili segment përbëhet nga dy degë LED për të garantuar vazhdimësinë e funksionimit edhe në rast defekti të pjesëshëm.

Pajisja duhet të jetë e disponueshme në dimensione nominale 200 mm dhe 300 mm, të përshtatshme për integrim në module standarde semaforësh. Versionet duhet të përfshijnë konfigurime monokolor dhe bikolor, me shfaqje numerike dyshifrore ose dy e gjysmë shifrore, në varësi të aplikimit. Lartësia e karaktereve duhet të sigurojë

---

lexueshmëri në distancë, duke arritur minimalisht 60 metra për diametrin 200 mm dhe 100 metra për diametrin 300 mm.

Ngjyrat e shfaqjes duhet të jenë në përputhje me standardin EN 12368 dhe të përfshijnë të kuqen, të verdhën dhe jeshilen. Pajisja duhet të jetë e aftë të konfigurohet në disa mënyra shfaqjeje, duke lejuar zgjedhjen e layout-it sipas rendit të fazave të semaforit dhe kërkesave të instalimit. Konfigurimi duhet të realizohet përmes një ndërfaqeje software të dedikuar.

Furnizimi me energji elektrike duhet të jetë në intervalin 150 deri në 265 VAC me frekuencë 47 deri në 63 Hz. Konsumi i energjisë duhet të jetë i ulët, në intervalin 3 deri në 12 W, duke e bërë pajisjen efikase nga pikëpamja energjetike. Pajisja duhet të jetë e përshtatshme për funksionim në kushte të vështira mjedisore, me temperaturë operative nga -40°C deri në +70°C dhe klasifikim klimatik sipas EN 12368.


Struktura mekanike duhet të jetë e realizuar nga materiale rezistente ndaj goditjeve, si polikarbonat i përforcuar, dhe duhet të garantojë mbrojtje ndaj pluhurit dhe ujit në nivelin IP65 sipas standardit EN 60598. Pajisja duhet të jetë rezistente ndaj rrezeve UV, lagështisë dhe vibrimeve që vijnë nga trafiku rrugor.

Instalimi duhet të jetë i thjeshtë dhe i shpejtë, duke mundësuar montimin brenda trupit të semaforit ose në një strukturë mbajtëse të veçantë, përmes elementëve të fiksimit dhe guarnicioneve izoluese. Pajisja duhet të jetë e projektuar në formë modulare për integrim të drejtpërdrejtë pa modifikime strukturore.

Pajisja duhet të jetë në përputhje me kërkesat për përputhshmëri elektromagnetike sipas standardit EN 50293 ose ekuivalent, si dhe të përmbushë kërkesat e standardit EN 12368 për performancën optike dhe funksionale të pajisjeve të sinjalistikës rrugore.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion të plotë teknik për produktin, duke përfshirë fletën teknike, deklaratën e konformitetit CE, certifikatat e përputhshmërisë me standardet përkatëse, si dhe manualin e instalimit dhe operimit. Produkti duhet të shoqërohet me një garanci minimale dyvjeçare.

Si kriter kualifikimi teknik, operatori ekonomik duhet të dëshmojë zbatimin e një sistemi të menaxhimit të energjisë në përputhje me standardin **ISO 5001:2018 ose ekuivalent**, duke reflektuar angazhimin për efikasitet energjetik dhe qëndrueshmëri në prodhimin e pajisjeve LED.




## 5. Shtylle xhirafe dhe shtylle e galvanizuar

Shtyllat e semaforëve duhet të prodhohen nga çelik strukturor me cilësi të lartë, të projektuara për të mbajtur pajisje semaforike me tre aspekte, si në konfigurim anësor ashtu edhe në atë me krah të zgjatur . Struktura duhet të garantojë qëndrueshmëri të lartë mekanike dhe rezistencë ndaj ngarkesave të erës dhe kushteve të funksionimit, duke përfshirë edhe forma të lakuara për krahët mbajtës sipas kërkesave të instalimit.

Të gjitha shtyllat duhet të jenë të galvanizuara me zhytje në të nxehtë, në përputhje me standardet përkatëse, me qëllim sigurimin e mbrojtjes afatgjatë ndaj korrozionit dhe kushteve atmosferike. Shtresa e zinkut duhet të jetë uniforme dhe rezistente ndaj lagështisë, rrezeve UV dhe faktorëve të tjerë mjedisorë.

Lartësia e shtyllave dhe dimensionet e krahëve duhet të jenë në përputhje me kërkesat e sigurisë rrugore, duke mundësuar instalim në lartësi rreth 2–3 metra për njësitë anësore dhe rreth 5–6 metra për konfigurimet mbi rrugë. Shtyllat duhet të jenë të pajisura me hapësira të brendshme për kalimin e kabllave, elementë fiksimi për pajisjet semaforike dhe pika aksesit për mirëmbajtje.



## 6. Rregullatori Semaforik

Rregullatori semaforik duhet te jete I dimensioneve 600x1100x350 mm ku te permbaje nje kompjuter 32 bit dhe nje sasi mikroprocesorësh per menaxhimin e imputeve dhe outputeve. Te furnizohet me rryme 230VAC – 50HZ. Bordi I kontrollit CPU te jete me protokoll TCP-IP ne menyre qe te jete e mundur nderlidhja me nje qender kontrolli si ne nje system LAN. Te kete nje ekran LCD deri ne 80 karaktere ne menyre qe te jete e thjeshte per tu kontrolluar.

### 6.1 Kapacitetet

Te kete 32 grupe sinjali me mundesi shtese deri ne 42 grupe. Ngarkese maksimale 800W / lllampe. Te kete 32 inpute dixhitale me mundesi shtese deri ne 80 inpute. Te kete 32 outpute dixhitale. Te kete mundesi te ruajtejes te 16 programeve te ndryshme kohore te cilat te mund te perzgjidhen nga ekran LCD ose qendra e kontrollit. Te kete dy porta seriale RS232 dhe nje port Ethernet me mundesi shtese deri ne kater porta RS232, dy porta USB, nje port 485. Mundesi dedektimi dhe kategorizimi te trafikut nepermjet 32 inputeve dixhitale ne 8 klasa gjatesie dhe 8 klasa shpejtesie. Mundesi te nderlidhjes me systemin qendror te kontrollit Tmacs. Te kete mundesi lidhje me modem GPRS ose fibra optike. Te kete menu operimi ne disa gjuhe te ndryshme.

## 6.2 Modalitete te funksionimit baze te rregullatorit

Pulsim, Te gjitha te kuqe, Manuale me buton ose me kontroll ne distance, Kohe automatike te regjistruara, Sinkronizim, Funksion GPS, aktivizim nepermjet leximit te trafikut me eliminim te fazave ose zgjatjen e tyre, funksioni I dritave te fikura, gjenerim dinamik I planit te menaxhimit ne baze te te dhenave te trafikut, system prioriteti per transportin public ose mjetet e emergjences, ndryshim automatik I ores gjate veres/dimrit, monitorimi I te gjitha llampave te lidhura, leximi dhe ruajtja e te gjithe informacionit te marre nga sensoret loop ose sensoret me mikrovale, monitorim ne distance dhe dergim automatic te SMS ose FAX ne rastet kur rregullatori ka defect, mundesi evedentimi te planit javor, mundesi evidentimi te planit ne rast te diteve te festive ose diteve te vecanta te vitit, ruajtja automatike e kodeve te defekteve ose ndryshimeve ne menyren e operimit, funksionim ne modalitet degjenerativ me algoritem menaxhimi te alarmeve, algoritem menaxhimi te prioritetit per tramvaj, tregimin e temperatures se brendshme, nivelit te fuqise se furnizimit si dhe goditjet nga tensioni I larte nepermjet ekranit LCD me 80 karaktere.

## 6.3 Kontrolli dhe pajisjet e sigurise te rregullatorit

Sipas EN12675, rregullatori përfshin një seri qarqesh kontrolli dhe Hardware te diferencuar per te garantuar nje siguri totale ne funksionimin korrekt te rregullatorit. Ne vecanti, kontrolli i papajtueshmërisë i dy dritave jeshile të ndezura njëkohësisht, kontrolli i kohës ndërmjet dritave jeshile në funksion të minimumit ne kohët e ndezjes dhe një matricë e programueshme, kontrollin e planit te kohes dhe korrektesine e kose se planifikuar, kontrollin e rrymës në të gjitha llambat e pranishme në system, kontrolli i ngarkesës i goditur nga rryma, kontrolli I kabujve te rene ne qark te shkurter.

## 6.4 Programimi I koheve te funksionimit software

Kohet e ndezjes jane te programueshme nga nje software I cili duhet te jete I prodhuar nga prodhuesi I rregullatorit, ku te jete lehtesisht I instalueshem ne sisteme operative MAC ose Windows ose Linux me paraqitje grafike te thjeshta dhe intuitive.

16 programe në memorie EEPROM të rishkruhen nga PC;

Kalimi automatik ndërmjet orës verore/diellore dhe anasjelltas;

Qarku i dyfishtë me funksionet e ndezësit emergjent;

Diagnostifikim i avancuar me tregues të saktë të shkakut të një mosfunksionimi të mundshëm;

Kontrolli i ngarkesave në tension;

Kontrolli i ngarkesave në rrymë (me pragje të programueshme);

Ndryshimi i programit javor;

Ndryshimi i programit festiv;

Përpyetje të konfigurueshme për rinisje;

Riprogramimi pa ndërprerë ciklin në vazhdim;

Testi akustik i detektorëve me mundësi për të përjashtuar të dëmtuarit;

Regjistrimi në EEPROM i alarmeve të gjetura dhe shkarkimi përmes kompjuterit;

Protokollet: TMacS, SPOT, SIGMA (Elsag)

## 6.5 Modulariteti

Bordi i furnizimit me energji elektrike: u jep fuqi skedave të tjera për të kontrolluar funksionimin e duhur i pajisur me ndezës emergjence, ndez sistemin në rast të dështimit të kartës së kontrollit. Bordi qendror i CPU-së trajton kontrolluesin e trafikut, këtu qëndron firmware-i i sistemit, konfigurimet e ndryshme dhe planet e trafikut. Të gjitha të dhënat ruhen në një qark mbështetje EEPROM. Karta mund të shtohet me platformën industriale të PC-së në standardin PC104: ky integrim lejon rregullatorin kontrollues për të komunikuar në çdo nivel me çdo sistem tjetër. Bordi I dedektimit ndërlihet me detektorët e automjeteve për të mbledhur dhe ruajtur të dhënat e trafikut. Të dhënat janë të disponueshme për përdorim për qëllime statistikore, ose përdoren drejtpërdrejt për menaxhimin dinamik të planit të koheve. Bordi Output OUT komunikon ndërmjet bordit logjik qendror dhe llampadareve të pajisura me gjashtë dalje llambash janë në gjendje të menaxhojnë dhe kontrollojnë 2 grupe të secilit sinjal. Tabela e kontrollit amperometrik TA bord në mbështetje të llampave output, për analizën e fuqisë konsumi i çdo fuqie dalje duke ndjerë djegien qoftë edhe të një llampe të vetme ose Moduli LED.

## 6.6 Bordet elektrike dhe aksesoret


Modaliteti i Rregullatorit të Trafikut duhet të jete një sistem elektronik multi-procesor i përbërë nga borde modulare elektronike me madhësi EUROPA (100 x 160 cm), të pajisura me panelin ballor mbulues dhe të vendosura në raft prej alumini alodini (19" i gjerë, 6U i gjatë dhe 220 mm i thellë). Të gjithë lidhësit e ndërfaqes me planet e pasme të jene sipas normave DIN 41612.

Sistemi modular të përbëhet nga tabelat elektronike ose modulet dhe aksesoret e mëposhtëm:

### • Paneli I fuqisë

Paneli I fuqisë është i fiksuar në pjesën e pasme të raftit dhe lejon vendosjen më së shumti prej 4 kartash OUT për çdo panel fuqie (për një total prej 24 llambash dalje). Numri i bordeve OUT dhe rrafshi i pasmë I panelit të fuqisë formon modulën e fuqisë së kontrolluesit. Modulet e fuqisë mund të vendosen krah për krah (ose nëse është e nevojshme në një raft me dy nivele) deri në maksimumin prej 96 dalje llambash me 4 module fuqie. Paneli I fuqisë

është i pajisur me një lidhës të pestë me qëllim që të lidhet një bord TA funksionues, krahas kontrollit në tension të ngarkesave, edhe atë të rrymës




### • Bordi OUT

Çdo bord përmban:

6 optoçifte triac për kontrollin e numrit të njëjtë të daljeve të llambave, të cilat janë të mbrojtura me siguresë.

Qarqet për kontrollin në tension në të gjitha daljeve për të zbuluar mungesën e ngarkesës dhe për menaxhimin e mbrojtjes për papajtueshmërinë e dy dritave jeshile të ndezura njëkohësisht.



### • Bordi TA

Bordi TA (opsionale) menaxhon kontrollin e rrymës në daljet e llambave, lejon zbulimin për çdo kanal të bordit OUT, nese një llambë digjet edhe nëse kjo është i lidhur paralelisht me të tjera llampa.

---

- Motherboard logjike

Motherboard logjike e pasme është ngjitur në pjesën e pasme të raftit për të lejuar futjen e kartave të furnizimit me energji elektrike, kontrollit (CPU) dhe detektorit (DET). Seti i kartave ALI, CPU, DET Motherboard logjike e pasme krijon formën logjike të rregullatorit të trafikut. Çdo rregullator kërkon vetëm një modul logjik.

- Bordi i trasformatorit të fuqisë

Ky bord siguron të gjithë fuqinë e nevojshme për sistemin që përfshin pajisjet e mëposhtme: Ndezje emergjente në rast të dështimit ose mosdisponueshmërisë së bordit të CPU.

- Bordi I fuqise

- Bordi kryesor i mikroprocesorit i quajtur bordi i CPU

Ky është bordi për menaxhimin kryesor të rregullatorit. Merret me të dhënat nga dhe për bord OUT, RIL dhe LCD, përveç drejtimit të procesit global dhe kontrollit të vazhdueshëm të pajisjes.

Karakteristikat e tij kryesore janë si më poshtë:

Mikroprocesor Multi 8 bit DHE 32 BIT.

Memoria e programit EEPROM nga 32 KB.

Orë në kohë reale me bateri të rikarikueshme NiHM.

Inputet optobashkues për 4 detektorët e pare.

Reset butonin e shtypjes për të anuluar sinjalet e prishjes ose alarmit.

Porta seriale RS232 me lidhësin DB9 për lidhjen me PC dhe ISP (në programimin e sistemit) për

mikroprocesor 8 bit, lidhje me marrësin GPS.

Porta BDM (Background Debug Module) për lidhje me PC dhe mikroprocesor 32 bit për ISP e programimit.


Porta Ethernet 10/100 Mbit në lidhësin RJ8

Led sinjalizimi për anomali dhe sinjalizime të tjera hyrëse/dalëse

Bordi i mikroprocesorit për hyrjen e detektorëve


Bordi i mikroprocesorit për daljen e fuqisë

Bordi ndihmës për kontroll në rrymë



### • Bordi DET

Ky bord (opsional) merret me menaxhimin e 32 hyrjeve që mund të përdoren me thirrjen nga detektorë dhe menaxhimi i komandave të centralizimit. Bordi RIL është i pajisur me një lidhës serial RS232 me 9 pole për lidhjen me PC dhe një lidhës i dytë serial RS232 me 9 pole për lidhjen me bordin e CPU-së në rast se përdorimi i modemit dhe/ose bus të jashtëm RS485.



### • Moduli i vizualizimit dhe programimit LCD

Njësia e mikroprocesorit me kristale të lëngshme shfaq 20 karaktere për 4 rreshta me ndriçim prapa. Ky bord shfaq gjendjen e funksionimit të kontrolluesit, lejon modifikimin e disa parametrave funksionalë dhe të konfigurimit, monitorimit të hyrjes/daljes, vizualizimit të orës, etj.

Te dhenat e ekranit LCD:

Ekran alfanumerik 4 rreshta x 20 karaktere;

7 tastet funksionale: FLASH, GJITHË KUQ, MANUAL, Atta, Sinkronizo, AUTO, FAKT.  
DINAMIKE funksioni: aktivizohet nga tasti "Fiks Time" "Actuated" "Sinkronizimi" kur shtypet për më shumë se 2 sekonda.


Menyja me 4 butona për hyrje/dalje: MENU', EXIT, PROG, CLOCK

Treguesi me 5 butona për të zgjedhur/redaktuar/konfirmuar

Sinjalizues për të sinjalizuar automjetet që kalojnë (zbulohet testi i dëgjimit)

Drita e sfondit për t'u fikur automatikisht pas rreth 2 minutash pas shtypjes së tastit të fundit

Kontrol ne distance nëpërmjet bus 485



• Moduli I lidhjes GPS

Njësia opsionale duhet të lidhet me portën seriale të CPU-së, ndërsa fuqia jepet drejtpërdrejt nga rregullatori. Njësia e menaxhimit është plotësisht automatike (norma Buad është dhënë tashmë me shpejtësi e saktë për komunikim me bordin e CPU-së), dhe transmeton çdo 10 sekonda të dhenat e data / ora përmes protokollit NMEA për përditësimin e orës së kontrolluesit (dhe kur ndryshon gjatë verës / dimrit). Në kohë të paracaktuara (3 herë në ditë), kontrolluesi shkon për të risinkronizuar rregullatorin kur duhet të funksionojë në modalitetin master/slave pa lidhje kabllore.

(GPS). Karakteristikat kryesore të njësisë:

20 kanale

SiRF III: WAAS i aktivizuar

Protokolli: NMEA 0183 V2.2

Konsumi i energjisë: 90 mA në 5V +/- 5% (tipike)

Antena: Brenda

• Moduli I komunikimit dhe transferimit

Moduli I komunikimit dhe transferimit duhet të jetë i përshtatshëm për të lidhur me platformën Tmacs si dhe me CPU-ne e rregullatorit ku të kete mundësi të kryeje ndryshime të programeve. Ky modul duhet të ketë të dhëna si më poshtë:

CPU Arch Arm 1 Ghz Cortex-A8

PRU-iCSS e programueshme në kohë reale 200 Mhz

Porte dalese HDMI me rezolucion 1280x1024 max (microHDMI)

Lidhje energjie nepermjet MiniUSB, USB ose dalje mashkull/femer VDC

Drita LED 4+1 për monitorimin e funksioneve

Ushqim energjie 8-28 VDC, <2VA

Fiksimi të kryhet në shufër me standart DIN (Standard t din 9 module)

SDRAM 512 MB, 800 Mhz DDR3L

eMMC 4 gb 8 bit

Hapsire për microSD

Porta komunikimi Serial 1 x RS485, 3XRS232, HS USB 2.0 client port, LS/FS/HS 2.0 HOST PORT, I2C bus për sensore, LAN ethernet 10/100, GPRS, Bluetooth.

Bateri e cila mban kohëmatësin në punë me precision +/- 5ppm

INPUTE/OUTPUTE – 4 x Input Analog 0-10 VDC/4-20mA, 4 x inute te optoizoluara 12-24 VDC, 14 x pin dixhital 0-3, 3 VDC, output releje 2xNO-NC; 2xNO 3A@24 VDC 3A@120 VAC, 4 x outpute te optoizoluara ne 24 VDC me 200 mA.

Konfigurimi I softuer, nderfaqe WEB. Sistemi operativ Linux 3.8 Kernel. Serveri web I brendshem per te komunikuar direk ose nderlidhje nepermjet LAN.

## **6.7 Nderlidhja me PC**

### **6.7.1 LIDHJE SERIALE ME BORDIN E CPU**

Bordi i CPU-së është i pajisur me një lidhës DB9 RS232, përmes të cilit mund të bëni lidhje me një PC për të kryer hapat e mëposhtëm:

Verifikim dhe programim te të dhënave në EEPROM të bordit të CPU-së

Lidhja midis PC dhe kontrolluesit në portën seriale me një shpejtësi prej 9600 baud (8 bit, jo barazi, 1 ndalesë)

Leximi dhe shkrimi i programeve dhe të dhënave

Me anë të kontrollit të posaçëm në PC mund të lexohet dhe/ose të modifikohet të gjitha tabelat në personalizim ose memorie te programeve.

### **6.7.2 LIDHJE SERIALE ME BORDIN RIL**

Bordi RIL është i pajisur me një DB9 RS232, përmes së cilës mund të bëni lidhjen me një PC për të kryer hapat e mëposhtëm:

Leximi i të dhënave të trafikut dhe programimi i parametrave të kampionimit në numërimin e makinës.

Lidhja midis PC dhe kontrolluesit në portën seriale me një shpejtësi prej 9600 baud (8 bit, jo barazi, 1 ndalesë). Për këtë qëllim duhet të përdoret sipër derës.

Porta e poshtme përdoret për t'u lidhur me portën RS232 të bordit të CPU-së në rastin e përdorimit të modemit ose bus i konvertuesit 485/232.

Leximi dhe shkrimi i programeve dhe të dhënave

Duke përdorur softuerin TMac, mund të lexoni / shkruani / modifikoni të gjitha të dhënat në kujtesën e konfigurimit në bordin RIL.

## **BOJE BIKOMPONENTE PASTE:**

Densiteti e bardhë: 1.85 – 2.05 g/cm<sup>3</sup>  
 Viskoziteti e bardhë (Daniel Flow) : 10-16

Raporti i miksimit: Substance reaktive me ngutesim lëng 0.5-3% për përdorim me makineri, paketim 25 kg.

Koha e Punimit: **5-25 min** (20°C)

Te jetë me dëshmi kontrolli për sistemin e shenjimit

Kontrolli i rezistences ndaj konsumit i karakteristikave në trafik të jetë i një sistemi shënjimi në kushtet e kontrollit të EN 1397 me një klasë P7 për ngjyrën e bardhë.

Aplikimi: Boja përpara përdorimit duhet të përzihet mirë dhe kushtet atmosferike të jenë në një temperaturë jo me te ulet se 5°C dhe jo me te larte se 30 °C. Norma e harxhimit 3.7 – 5.3kg/m<sup>2</sup>. Koha e tharjes <55min.

Koordinatat kromatike të bojës duhet të jenë si më poshtë:

Te jetë me dëshmi kontrolli për sistemin e shenjimit për ngjyrën e bardhë.

Kontrolli i rezistences ndaj konsumit i karakteristikave në trafik të jetë i një sistemi shënjimi në kushtet e kontrollit të EN 1397.

Klasat e karakteristikave të trafikut të bazohen tek EN 1436.

Sistem shënjimit të jetë me copëza të trasha për shënjime permanente

Lloji i materialit:	Substance reaktive me ngurtesim në të ftohtë (plastike me spërkatje të ftohte)
Forcuesi:	100:1 forcues lëng
Trashësia e shtresës (µm ):	2.000
Procedura e aplikimit:	Me pajisje manuale tip “këpucë shtrirëse” (screed shoe), për aplikim të kontrolluar të materialit plastomerik në trashësi konstante.
Sasia e trupave reflective:	450 g/m <sup>2</sup>
Të përmbushen kërkesat për klasen e trafikut P7. Për karakteristikat individuale të karakteristikave të trafikut të arrihen klasat si më poshtë:	
Shikushmeria natën në të thatë:	R 5
Shikushmeria natën në lagështi:	RW 3
Shikushmeria ditën:	Q 5
Rotullueshmeria:	T 4
Të përmbushen kërkesat minimale për rezistencën ndaj konsumit prej 90% të sipërfaqes së mbetur.	

Vlerat mesatare të matura të jenë:

Klasa e kërkuar e trafikut:	P 7
Klasa e aritur e trafikut:	P 7
Koha e tharjes (min):	9

### **Karakteristikat Fiziko-Kimike:**

Karakteristikat	SHUMA E RROTULLIMIT TE GOMES							
	0.01	0.1	0.2	0.5	1	2	3	4
Rezistenca ndaj konsumit (%)	99	99	99	99	99	99	99	99
Shikueshmëria natën – e thatë, RL	304	375	421	443	419	375	343	300
Shikueshmëria natën – në shi, RL	32	41	26	26	43	47	28	25
Shikueshmëria natën – e lagësht, RL	87	115	89	61	93	116	61	57
Shikueshmëria ditën, Qd	277	278	278	276	269	268	264	263
Koordinata x	0.325	0.325	0.325	0.327	0.326	0.326	0.326	0.326
Koordinata y	0.343	0.342	0.343	0.344	0.343	0.344	0.343	0.343
Faktori i luminancës $\beta$	0.726	0.735	0.751	0.777	0.786	0.778	0.794	0.784

Boja duhet të jetë e ambalazhuar në kova me peshë nga 25 kg.

Në trupin e kovës duhet të shënohet data e prodhimit dhe/ose skadencës së saj.

**SHËNIM:** Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator specifik ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët ose “*ekuivalente*”.

**Shtojca 6.**

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/ kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

**GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE**

Nr	Përshkrimi	Njësia	Totali	
			Sasia	
1	F.V Llampadar për automjete, LED 1x300 mm dhe 2x200, Kuqe/Portokalli/Jeshile	copë	8	8
2	F.V Llampadar për automjete, LED 2x200 mm, me maskë këmbësori, Kuqe/Jeshile (dinamike)	copë	4	4
3	F.V Shtyllë e galvanizuar, D114 mm, H=3,6m	copë	2	2
4	F.V Shtyllë xhirafe e galvanizuar H=5,5 m	copë	2	2
5	F.V Panel kontrasti	copë	4	4
6	F.V Numurator për makina D 300	copë	2	2
7	F.V Numurator për këmbësor D 200	copë	4	4
8	F.V Kontrollues trafiku, 220 VAC 50HZ, 4 grupe	copë	1	1
9	F.V Kabëll 7x1,5	ml	110	110
10	F.V Kabëll 4x1,5	ml	60	60
11	F.V Kabëll 4x2,5	ml	120	120
12	Vijejim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikomponente paste (me pika)	ml	200	200
13	Vijejim bikomponent paste, vije stopi, kalim kembesoresh etj.	m2	6	6

**Shtojca 7.**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT****1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseçq ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2023, 2024, 2025**) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. *Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2023, 2024, 2025**), ku vlera e xhiros për të paktën (një) nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40%** e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. *Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për vitin **2026** (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar). Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një deklaratë për shlyerjen e detyrimeve vendore ose vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, deklaratën ose vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

*Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

**a)** Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

**b)** Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**2.3.2** Operatorët ekonomik duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”*. Shqyrtimi i licencave do të behet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa me sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- NP – 11/A (Ndërtime për nënstationet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)
- NP—12/A (Punime të inxhinierisë së mjedisit.)
- NP - 5/A (Punime nentokesore, ura e vepra arti)
- NS – 18/A (Punime topogjeodezike)
- NS - 5/A (Impiante të sinjalistikës ndricuese të trafikut.

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor dhe mbështetës, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) inxhinier Mekanik
- 1 (një) inxhinier Mjedisi
- 1 (një) inxhinier Topograf/ Gjeodet/ Markshajder
- 1 (një) inxhinier Elektrik

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë: *Për secilin pjestar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë, Kontratë pune e vlefshme, diplomë, Libreze pune dhe CV, (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi).*

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar si më poshtë:

1 (një) punonjes i pajisur me çertifikuar “Ekspert për ndihmen e parë dhe nderhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e leshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

1 (një) punonjës që disponon çertifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

1 (një) punonjes që të disponojë çertifikatë si “ Auditues/ Insepektues i Sigurisë Rrugore (auditin e sigurisë rrugore dhe menaxhimin e pikave të zeza)” lëshuar nga Institucionet Kompetente Shtetërore në përputhje me klauzolat e Direktivës 2008/96/EC ose ekuivalente.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë: diplomë / Çertifikatat e cituara më sipër dhe Kontrate pune.

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamionçinë me kapacitet mbajtës jo më pak se 1,5 – ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinç të integruar	1 copë	Pronësi ose me qera
Kompresor (i lëvizshëm)	1 copë	Pronësi ose me qera
Karrel për sinjalizim të punimeve në rrugë	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera

Freze asfalti	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri vijezi bikomponente, per vija me pika	1 copë	Pronësi ose me qera

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, si më poshtë:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).
- Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën e për transport mallrash brënda vendit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerese me objekt te percaktuar, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- Per mjetet e vijeziimit te paraqitet skeda teknike e perkthyer me qellim verifikimin e llojit te mjetit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- Per mjetet qe transportojne mjete te renda duhet te paraqitet certifikata perkatese e leshuar nga institucioni kompetent.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesi certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (*ose ekuivalente*) për objektin qe prokurohet, si më poshtë:

<b>ISO 9001:2015</b>	Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
<b>ISO 14001:2015</b>	Sistemet e Menaxhimit Mjedisor
<b>OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001</b>	Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë
<b>ISO 50001:2018</b>	Sistemet e Menaxhimit të Energjisë

- Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

- Certifikatat duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të plotësojë deklaratën e garancisë për funksionimin e semaforëve për një periudhë jo më pak se **2** (dy) vite.

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori ku merr përsipër që pas mbarimit të procesit të punës (*pasi të mbarojë vendosja e semaforit*) dhe të funksionojë çdo gjë në rregull, të rikthejë në gjendjen fillestare rrugën dhe trotuarin.

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet të paraqesë: Autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar për mallrat **1-8** dhe **12-13** sipas preventivit të procedurës së prokurimit, (*për gjuhën e huaj duhet të ketë përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe*).

Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet prodhuesit dhe distributorit të autorizuar. Secili nga dokumentet duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**2.3.10** Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mallrat **1-8** dhe **12-13** sipas preventivit të procedurës së prokurimit, katalogët dhe/ose skedat teknike ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve, me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike. *Katalogët duhet të paraqiten në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuar.*

**2.3.11** Operatori ekonomik duhet të paraqesë në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave, tek Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz, **mostra për artikujt 1 dhe 7** objekt prokurimi, si dhe bojën bikomponente pastë në amballazhin origjinal sipas specifikimeve teknike.

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.
- Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik.

**Mosparaqitja e mostrave përbën shkak për skualifikim.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shtojca 8.**

### **FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

### A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

### B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është</p>

<p>parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
